

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË STATISTIKAVE ZYRTARE 2022-2026”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit është përcaktimi i objektivave zhvillimore të Sistemit Kombëtar Statistikor, aktiviteteve statistikore, afateve të zbatimit, përgjegjësiive të institucioneve prodhuese statistikore dhe institucioneve furnizuese me të dhëna statistikore, për periudhën 2022-2026 në Republikën e Shqipërisë, në përmbushje të detyrimeve që lindin nga ligji nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

Objektivat që synohen të arrihen:

1. Përshkrimi i objektivave zhvillimore të statistikave zyrtare;
2. Përshkrimi i aktiviteteve statistikore kryesore për secilën fushë, sipas ligjit për statistikat zyrtare;
3. Përcaktimi i frekuencës së aktiviteteve dhe nivelit të përputhshmërisë me *acquis*;
4. Përcaktimi i indikatorëve të performancës së Sistemit Kombëtar Statistikor;
5. Përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për furnizimin me të dhëna administrative;
6. Përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare;
7. Analiza e burimeve financiare dhe njerëzore, si dhe aspektet e menaxhimit të riskut.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026” rrjedh si detyrim i zbatimit të neneve 7 dhe 8, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë që do të sjellë projektligji janë kryesisht:

- a) Zbatimi i kërkesave të ligjit nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”;
- b) Do të sigurojë përmbushjen e rekomandimeve të BE-së, për sa i takon miratimit të një programi statistikor, në përputhje me kërkesat e rregullores 223/2009, “Për statistikat evropiane”;
- c) Do të mundësojë përcaktimin e përbërjes së Sistemit Kombëtar Statistikor në Shqipëri;
- ç) Do të mundësojë konkretizimin e institucioneve përgjegjëse për dhënien e së drejtës së hyrjes në të dhënat administrative që disponojnë, vetëm për qëllime statistikore;
- d) Do të përcaktojë afatet e kryerjes së aktiviteteve për secilën fushë statistikore;
- dh) Do të rrisë transparencën e institucioneve të angazhuara në proceset e prodhimit statistikor zyrtar, duke rritur imazhin dhe besueshmërinë e përdoruesve në statistika;
- e) Do të përcaktojë aktivitetet që i dedikohen dy projektligjeve madhore gjatë pesë viteve të ardhshme: censi i popullsisë dhe banesave dhe censi i bujqësisë;
- ë) Do të lehtësojë procedurën e monitorimit të zbatimit të programit, nëpërmjet indikatorëve të performancës, të lidhur me secilin objektiv strategjik.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji hartohet si rrjedhojë e parashikimeve të neneve 7 dhe 8, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, i cili, nga ana tjetër, është përafëruar pjesërisht me nenin 13 “*European Statistical Program*” të rregullores (KE), nr.223/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 mars 2009, e ndryshuar me rregulloren (KE) nr.2015/759, datë 29 prill 2015, me qëllim ngritjen e kornizës ligjore, në përputhje me standardet e kërkuara nga BE-ja dhe Eurostat-i, në bazë të së cilës e ushtrojnë veprimtarinë e tyre sistemet kombëtare statistikore të vendeve anëtare.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE TË BE-SË* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me *acquis* të BE-së. Megjithatë, për secilën fushë statistikore është pasqyruar niveli i përputhshmërisë së veprimtarisë statistikore me kërkesat e akteve komunitare përkatëse, si dhe pritshmëritë e përafrimit në pesë vitet e ardhshme. Informacioni dhe vlerësimi do të shërbejë për hartimin e programeve kombëtare për integrimin evropian për kapitullin 18, “Statistikat”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026 hartohet në zbatim të neneve 7 dhe 8, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”. Sipas këtyre dispozitave, PSZ-ja duhet të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor, për periudhën pesëvjeçare dhe duhet të përmbajë aktivitetet statistikore kryesore, të cilat duhet të kryhen nga prodhuesit e statistikave zyrtare gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, PSZ-ja duhet të specifikojë institucionet e ngarkuara për prodhimin e statistikave zyrtare dhe institucionet furnizuese me të dhëna administrative.

Ligji për statistikat zyrtare ngarkon INSTAT-in të përgatisë projektprogramin, në bashkëpunim të ngushtë me grupet e interesuara për statistika zyrtare. Pas marrjes së mendimit të Këshillit të Statistikave dhe nëpërmjet Këshillit të Ministrave. Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim përfundimtar.

Duke pasur parasysh strukturën e kërkuar nga legjislacioni kombëtar dhe rregulloret e BE-së për statistikat zyrtare, si dhe duke u bazuar në eksperiencën 30-vjeçare të tij, INSTAT-i ka arritur të ndërtojë një program, i cili do të jetë pranë përdoruesve dhe publikut, për sa i takon të kuptuarit të veprimtarisë statistikore në vend. Nga ana tjetër, meqenëse përmban për herë të parë indikatorë konkretë performance, dokumenti është i strukturuar në mënyrë të tillë që do të lehtësojë proceset e monitorimit dhe raportimit të ecurisë së Sistemit Kombëtar Statistikor.

PSZ-ja 2022-2026 përmban në total IX kapituj, të cilat mbështeten në informacione më të detajuara në anekset përkatëse, që i bashkëlidhet këtij dokumenti.

Kapitulli I i kushtohet paraqitjes së informacionit mbi sfidat e programit të ri 2022-2026, si dhe qasjes krahasimore me programin 2017-2021, lidhur me aktivitetet përmirësuese në aspektin e metodologjisë, metodave të mbledhjes së të dhënave, afateve kohore, transmetimit të të dhënave në Eurostat, si dhe treguesve të rinj apo publikimeve të reja.

Kapitulli II fokusohet në atë çfarë kërkohet konkretisht nga ligji për statistikat zyrtare, si objektivat zhvillimorë të SKS-së, masat për arritjen e tyre, si dhe indikatorët e monitorimit të performancës. Për shkak të natyrës strategjike të dokumentit, me synimin që ai të integrohet në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar (IPSIS), INSTAT-i ka përshtatur këtë kapitull pjesërisht në përputhje me formatet e kërkuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin për Zhvillim dhe Mirëqeverisje në Kryeministri.

Kapitulli III përshkruan aktivitetet statistikore, që do të kryhen nga prodhuesit e statistikave zyrtare gjatë pesë viteve, të ndara sipas fushave statistikore të përcaktuara në shtojcën 1, të ligjit për statistikat zyrtare. Aktivitetet shoqërohen edhe me informacionin mbi nivelin e përputhshmërisë me *acquis communautaire*, burimet e të dhënave administrative dhe nevojat për burime njerëzore të cilat do të mundësojnë arritjen e këtyre aktiviteteve.

Kapitulli IV përmban një informacion mbi situatën e statistikave të nivelit vendor dhe vizionin e INSTAT-it për shtimin e treguesve të këtij niveli, me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave të institucioneve të vetëqeverisjes vendore.

Kapitulli V liston institucionet e ngarkuara nga programi për prodhimin e statistikave zyrtare, si dhe numrin e aktiviteteve që do të kryejnë përkatësisht.

Kapitulli VI pasqyron kuadrin rregullator, për të cilin mbështetet veprimtaria statistikore në vend.

Kapitulli VII jep informacionin për sistemin e menaxhimit të cilësisë, për të garantuar prodhimin e statistikave cilësore në vend.

Kapitulli VIII jep parashikimet e burimeve financiare dhe njerëzore të INSTAT-it, të nevojshme për zbatimin e programit.

Kapitujt IX dhe X kanë të bëjnë me analizën *SWOT* dhe menaxhimin e risqeve dhe problemeve të pritshme, të cilat kërkojnë marrjen e masave përkatëse parandaluese për të siguruar suksesin e zbatimit të programit.

Statistikat e paparashikuara, por të kërkuara për t'u prodhuar në periudhën e programit, do të konsiderohen si statistika zyrtare, në rast se ato përfshihen në planin vjetor të radhës. Në lidhje me zbatimin e programit deri në vitin 2026, statistikat e identifikuar për t'u prodhuar nga agjencitë e tjera do të konsiderohen si statistika zyrtare.

Procedura për hartimin e programit

Bazuar në kërkesat e ligjit për statistikat zyrtare, ku programi pesëvjeçar shoqërohet me një plan vjetor veprimi, ndryshe nga PSZ-të e mëparshme, ky dokument është më tepër i natyrës strategjike sesa operationale. Kjo kërkoj që INSTAT-i të rishikonte mënyrën e ndërtimit dhe marrjes së *in-puteve* për hartimin e projektdokumentit. Për pasqyrimin e objektivave zhvillimorë, INSTAT-i është mbështetur në projektstrategjinë e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor 2018-2030, dokument i cili është përgatitur me mbështetjen e Bankës Botërore. Për sa i takon aktiviteteve statistikore, INSTAT-i është bazuar në shtojcën 1, të ligjit për statistikat zyrtare për klasifikimin e fushave statistikore, duke e përshtatur edhe me strukturën e *Compendiumit* 2019 të Eurostat-it.

Veç kësaj, një arsye tjetër për përdorimin e kësaj strukture ka qenë edhe fakti se ky program është në të njëjtën linjë me atë kombëtar për integrimin evropian. Struktura e përgjigjeve për progresin në kapitullin 18, “Statistikat”, të *acquis communautaire*, ku INSTAT-i është institucioni përgjegjës koordinues dhe është e ndërtuar në të njëjtën formë me këtë program (në nivel fushe).

Fillimisht, si institucioni përgjegjës me ligj për hartimin e programit, INSTAT-i ka ngritur grupin kryesor të punës, në përbërje të së cilit janë nëpunësit e nivelit më të lartë të INSTAT-it. Më tej, janë ngritur ekipet teknike për secilën fushë statistikore, të nivelit ndërinstitucional, në përbërje të të cilëve kanë qenë specialistë nga INSTAT-i dhe institucionet e tjera prodhuese ose furnizuese me të dhëna administrative. Ekipet teknike janë drejtuar nga përfaqësuesit e INSTAT-it.

I gjithë informacioni i krijuar është hedhur në një bazë të veçantë të dhënash, e cila ndihmon për hartimin e tabelave të ndryshme informative, për të vlerësuar se çfarë prodhon sistemi statistikor në Shqipëri, kur dhe si i prodhon, cilat janë agjencitë përgjegjëse për t’i prodhuar dhe institucionet përgjegjëse për sigurimin e informacionit, cila do të jetë forma dhe afati i publikimit të statistikave të prodhuara etj.

Nëpërmjet kësaj baze të krijuar të dhënash, është bërë e mundur të hartohen edhe tabelat e këtij programi, ku çdo i interesuar mund të orientohet për të marrë informacionin e lartpërmendur. Gjithashtu, tabelat ndihmojnë veçanërisht për të përcaktuar burimin e të dhënave, administrative ose jo, duke pasqyruar konkretisht institucionet e ngarkuara për sigurimin e informacionit.

Përveç parashikimeve sipas ligjit për statistikat zyrtare, duke pasur parasysh kushtet e Shqipërisë dhe nivelin jo të plotë të përputhjes me *Compendiumin 2019*, programi përmban edhe disa shtesa dhe ndryshime të moderuara në nivel nënteme. Sidoqoftë, linja logjike e strukturës është arritur të ruhet sipas ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet përgjegjëse që ngarkohen me zbatimin e projektligjit janë:

- Instituti i Statistikave;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Banka e Shqipërisë;
- Institucionet furnizuese me të dhëna administrative sipas projektprogramit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga stafi i INSTAT-it me kontributin e Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshillit të Statistikave dhe Bordit Drejtues të INSTAT-it, si dhe të stafeve të institucioneve që japin të dhëna administrative për qëllime statistikore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Të ardhurat për kryerjen e aktiviteteve të programit janë të parashikuara në buxhetet përkatëse të INSTAT-it, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Bankës së Shqipërisë, brenda taveve të përcaktuara në PBA 2022-2024.

KËSHILLI I MINISTRAVE